

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"AJ CONSTRUCTION" SHPK

Sot më datë 11/11/2022 unë e quajturi JulianTroksi, atësia Renato lindur më datë 16/01/1992, aktualisht banues në Fushë-Krujë, Krujë i identifikuar me kartë identiteti numër personal: J20116069B dhe unë Arlind Babasi, atësia Lulzim lindur më datë 02/09/1993, aktualisht banues në Tiranë me kartë identiteti numër personal: J30902060Ë në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Përtregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 për Q.K.R, vendosëm të themelojmë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar "AJ CONSTRUCTION" Shpk dhe për këtë qëllim hartojmë Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara si më poshtë vijon:

NENI 1
EMERTIMI I SHOQERISE

1.1 Emri i shoqërisë është "AJ CONSTRUCTION" Shpk (më poshtë e quajtur "Shoqëria")

NENI 2
SELIA LIGJORE

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: , Fushe – Kruje ,Hasan, Rruga Nacionale Fushë Krujë - Vorë, Zona kadastrale 1934, numër pasurie 62/4.

2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3
KOHE ZGJATJA

3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

NENI 4
OBJEKTI

4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

- Aktivitet import-eksport, shërbime kompjuterike, konsulenca dhe shitje produkte online, etj, ndermjetsim në fushën e import-eksportit, shitje
- Blerje, shërbime konsulence në fushën e import-eksporteve, aktivitet në fushën e regjimit të përpunimit aktiv, ndërmjetësim, nënkontraktim me të tretë për çdo hap të domosdoshëm në fushën e regjimit të përpunimit aktiv si dhe çdo veprim tjetër të parashikueshem nga ligji për sa i përket objektit të mësipërm.

- Prodhimin, tregtimin dhe transportimin e materialeve inerte si: rëra, gurë, zhavorre, cakull, gëlqere dhe granile.
- Ndërtime civile, industriale, turistike e buqësore. Rikonstrukcion të këtyre lloj ndërtimesh.
- Ndërtime godinash shumëkatëshe banimi, ndërtimi vilave, pallateve.
- Ndërtim rrugësh dhe autostradash, punime të mirëmbajtjes dhe sinjalizimit në rrugë.
- Punime shërbimi si pastrim, mirëmbajtje dhe zhvillimi dekorit sipërfaqesh urbane.

4.2 Për të realizuar objektin e aktivitetit të saj, Shoqëria mund të veprojë brenda dhe jashtë Shqipërisë, si dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm, të lidhur, instrumental, të përafërt, elementar, ose sidoqoftë të dobishëm, përsëmbull:

- Të ofrojë garanci reale dhe/ose personale si për detyrimet e veta, ashtu edhe për tjetret. Të marrë përsipër, të lejojë dhetë heqë dorë nga pjesëmarrje direkte ose indirekte në shoqëri të tjera dhe ndërmarrje, si Shqiptare ashtu edhe të huaja, që kryejnë veprimtarinë e tyre, me qëllim që të lehtësojnë realizimin e objektit të shoqërisë.
- Veprimtari tregtare dhe industriale, import dhe eksport të mirash, shërbimesh dhe produktesh;
- Në kuadër të ligjit, të krijojë veprimtari dhe filiale përfaqësime.

NENI 5 KAPITALI I SHOQERISE

- 5.1 Kapitali Themeltar i Shoqërisë është i barabartë me vlerë 100.000 lekë (njëqind mijë lekë), me kontribut në para nga 2 (dy) ortakët:
- 5.2
- 5.3 Julian Troksi me 1 kuote me 50% të kapitalit me 50.000 Leke
- 5.4 Arlind Babasi. me 1 kuote me 50% të kapitalit me 50.000 Leke
- 5.5 Asnjë nga ortakët nuk mund të transferojë kuotën përkatëse të pjesëmarrjes në Shoqëri pa miratimin paraprak me shkrim të ortakut tjetër. Në rast se një nga ortakët dëshiron të kalojë/transferojë plotësisht apo pjesërisht kuotën e tij në Shoqëri, duhet t'ia ofrojë këtë kuotë për blerje ortakëve të Shoqërisë. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga ofrimi i kuotës për blerje, ortakët do të kenë të drejtën të blejnë kuotën e ofruar në shitje sipasçmimit dhe mënyrave të pagesës për të cilat kanë rënë dakord me ortakun shitës.
- 5.6 Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesëtim të drejte me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.

NENI 6 KALIMI I KUOTES ME TRASHËGIMI (MORTISCAUSA) OSE PER SHKAK TE FALIMENTIMIT TE ORTAKUT

- 6.1 Në rast vdekjeje apo falimentimi të njërit prej ortakëve, kalimi i kuotës dhe i të drejtave përkatëse në favor të trashëgimtarëve apo personave që fitojnë në këto të drejta duhet të miratohet nga

Asambleja e Përgjithshme, e cila duhet të shprehet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i vdekjes apo i falimentimit të ortakut. Në rast refuzimi të pëlqimit apo nëse Asambleja e Përgjithshme nuk është shprehur brenda afatit të sipërpërmendur, Shoqëria do t'ju paguajë trashëgimtarëve apo personave që fitojnë këto të drejta vlerën e kuotës që do të përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme, duke pasur parasysh gjendjen pasurore të Shoqërisë dhe vlerën e tregut të kuotës.

- 6.2 Personi që fiton të drejtën mbi kuotën e pjesëmarrjes për shkak të vdekjes apo falimentimit të një ortaku mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të zgjedhur prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton Shoqërinë në lidhje me këtë vendim.
- 6.3 Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë për shkak të vdekjes apo falimentimit të një ortaku do të këtë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si zotërues i kuotës.

NENI 7 ZMADHIMI I KAPITALIT

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.10 të këtij Statuti. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur, por që se nuk janë të pranishëm në mbledhjen e Asamblesës së Përgjithshme që vendos për zmadhimin e kapitalit.
- 7.2 Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjesëtim të drejtë me kuotat qëzotërojnë në Shoqëri.
- 7.3 Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i pa nënshkruar prej tyre mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë serish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit në përpjesëtim të drejte me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

NENI 8 ZVOGELIMI I KAPITALIT

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.10 të këtij Statuti. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.
- 8.2 Ortakët e përballojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

NENI 9

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.
- 9.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.
- 9.3 Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një person tjetër, me prokurëmeshkrim.
- 9.4 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme në përmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (konferencë call) audio ose video, në përputhje me ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare dhe ligjin për komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.
- 9.5 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratorët ose nga ortakët në bazë të nenit 84 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare". Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara Shoqërisë të paktën 7 (shtatë) dite përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, kur ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord të vendosin në lidhje me rendin e ditës.
- 9.6 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratorët. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje ndër personat e pranishëm.
- 9.7 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përshij në dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 9.8 Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 9.9 Asambleja e Përgjithshme, përveç se për sa parashikon neni 9.10 i këtij Statuti, për vendime që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, sipas nenit 86 pika I, të Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare".
- 9.10 Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të paktën 51 % të ortakëve pjesëmarrës (shumica e kualifikuar) në bazë të nenit 87 pika I, të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare", për ndryshimin e këtij Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

NENI 10

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

- 10.1 Shoqëria administrohet nga Administratori/ët i cili/të cilët emërohen për një periudhë kohore prej maksimumi 5 (pesë) vjetësh. Administratori/ët mund të rizgjidhen dhe shkarkohen në çdo kohë nga Asambleja e përgjithshme.
- 10.2 Adminiostrator i shoqërisë do të jetë z **Arlind Babasi**.
- 10.3 Administratori/ët zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë, përveç veprimeve, përmbushja e të cilëve i rezervohet Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryeragjatë administrimit të Shoqërisë dhe mund të autorizojë persona të treta, për të përmbushur veprime të caktuara, në emër dhe për llogari të Shoqërisë. Në çdorast, administratori do të jetë përgjegjës për veprimet e të tretëve të autorizuar.
- 10.4 Asambleja e Përgjithshme vendos shpërblimin e administratorëve teshoqërisë.
- 10.5 Administratorët nuk do të mund të marrin hua nga Shoqëria ose të lëshojnë garanci, dorëzani, në emër dhe për llogari të Shoqërisë, për hua dhe financimet e dhëna nga të tretët.
- 10.6 Administratorët do të veprojnë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti interesi, Administratori do të njoftojë me njëherë ortakët si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 11

VITI FINANCIAR

- 11.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon me 01 Dhjetor dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti.

NENI 12

KONTROLLI FINANCIAR

- 12.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Autorizuar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 12.2 Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në atë raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

NENI 13

BILANCI VJETOR

- 13.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit administrativ mbi ecurinë e veprimtarisë sociale dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e përgjithshme.
- 13.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

NENI 14 DIVIDENDET

- 14.1 Në përputhje me dispozitat ligjore, Asambleja e Përgjithshme vendos mbi shpërndarjen e dividendëve në bazë të rezultatit financiar të shoqërisë.

NENI 15 ZGJIDHJA E MOSMARRREVESHJEVE

- 15.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, administratorëve, likujduesit, do t'i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

NENI 16 GJUHA


- 16.1 Ky Statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.

NENI 17 DISPOZITA PERFUNDIMTARE

- 17.1 Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut dhe në përputhje me legjisllacionin shqiptar në fuqi.
- 17.2 Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, do të zbatohen parashikimet e ligjit nr. 9901 i datës 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare".

ORTAKET E SHOQERISE

Julian TROKSI



Arlind BABASI

